

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 21679/26

Nr. i fq. / Br. st. - 4 -

Data: / Datum: 28.05.2026

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 89/26, 26.05.2026**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28 prill 2026 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Kushtrim Hyseni, Xhon Gubetini, Blerina Shala, Fatmire Cecelia, Ymer Haradinaj dhe Gentiana Rama (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, si dhe Mentor Jashari, nga Drejtoria për Shërbime Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo propozoi që të hiqet pika 3 nga rendi i ditës “Draft – Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë”, pasi që sponzoruesi ka kërkuar një gjë të tillë. Nëse ka nevojë ndonjë sqarim shtesë, e kemi përfaqësuesin e drejtorisë të pranishëm në mbledhje z. Mentor Jashari.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – sa i përket Draft – Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, konsideroj se tarifa që është propozuar 10 euro për ekonomitë familjare është e lartë. Pra, nga 6 euro në 10 euro është një tarifë e lartë. Asnjë komunë në Kosovë nuk ka tarifë më të lartë se 6.5 euro. Ai kërkoi që në komision për hartim të draft-rregullores, të ketë anëtarë edhe nga kuvendi. Po ashtu, procesverbalet e konsultimit publik t'i bashkangjiten draftit të rregullores.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se kjo rregullore ka pasur nevojë të ndryshohet, për shkak se nuk është bërë si duhet kategorizimi i bizneseve. Propozimi për ngritjen e çmimit për ekonomitë familjare nga 6 në 10 euro është shumë i lartë. Asnjë komunë nuk e ka aq të lartë çmimin.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri vendosi që të hiqet nga rendi i ditës pika 3 “Draft – Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë”.**

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

## R E N D D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.03.2026;
2. Raport i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026;
3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në rr. “Ismail Parduzi në Vushtri sipas gjendjes faktike;
4. Propozim – vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e rregullores për punën e kuvendit.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.03.2026.

### *Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 23.03.2026.*

2. Raport i shpenzimeve për periudhën janar – mars 2026.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se kemi një risi të investimet kapitale, për dallim nga vitet e kaluara. Pata propozuar në nivel të kolegjiut të drejtorëve, që të hapet një kod ekonomik burimor për vendimet gjyqësore dhe përmbartimore. Arsyeja ka qenë se çdo komunë ka pasë problematikë të njëjtë. Kjo ka ndodhur vetëm tani. Qeveria ka hap kodin buxhetor 0040 – ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, sipas nenit 40, të Ligjit të financave publike dhe përgjegjësitë. Tash ceket në detaje se ku janë marrë mjetet financiare dhe për çfarë janë realizuar. Pra, vetëm këtë tremujor, pa e llogarit ditën e premtë, janë marrë mjete financiare për vendime gjyqësore mbi 2 milionë euro. Edhe këtë vit, komuna jonë dhe komunat tjera ballafaqohen me çështjen e vendimeve përmbartimore si pasojë e kontratës kolektive, që po na përcjell që disa vite. Prandaj, çdo plan buxhetor nuk mund të realizohet ashtu siç janë marrë vendimet në kuvend, apo sipas planifikimit të realizimeve të investimeve kapitale. Sa i përket këtij raporti, realizimi është 89%. Po ashtu, edhe te të hyrat vetanake kemi një realizim të mirë të inkasimit. Te shpenzimet tjera ekonomike, ne po merremi me obligimet të cilat i kemi nga viti i kaluar. Kurse, obligimet e reja, vetëm ato të cilat janë emergjente jemi duke i procesuar.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – sa i përket këtij raporti, granti qeveritar për këtë periudhë ka qenë 12,940,247.91€, kurse realizimi është 11,507,887.58€. E shprehur në përqindje i bie 89%. Sa i përket të hyrave vetanake është 74%, kurse realizimi është vetëm 29%, shumë pak. Nuk e di pse. Shumica e këtyre mjeteve shkojnë për paga dhe mëditje. E kam cekur në kuvend, se një numër i mësimdhënësve ankohen se punojnë për një periudhë të caktuar kohore dhe nuk janë në listën e pagave dhe nuk paguhen për punën që e bëjnë. Kemi rritje të shpenzimeve në: shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit; para xhepi-mëditje për udhëtime zyrtare brenda vendit; shpenzime të vogla – para xhepi; akomodimet e udhëtimit zyrtar jashtë shtetit, shërbimet teknike; furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare); sigurimi i automjeteve; mirëmbajtja e rrugëve lokale – rritje enorme e

shpenzimeve; qiraja për automjete është dyfishuar ( a janë marrë automjete shtesë me qira?)

Desha ta pyes drejtorin se në dy faqet e fundit, tek rubrika e përqindjes – kemi 0%. A është gabim teknik?

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – deklaroi se kemi rritje të shpenzimeve për para xhepi, ku në periudhën e njëjtë të vitit 2025 kanë qenë zero, kurse tani kemi 2,652.80€. Këto janë ato që nuk mund të arsyetohen se s'ka buxhet, kur shihen këto rritje të shpenzimeve. Kodi 14060 “mirëmbajtja rulinore”, a është gabim teknik? Pse kjo shumë kaq e madhe e shpenzimeve prej 262,561.00€.

A janë blerë drutë për ngrohje apo janë paguar të vitit të kaluar? Kjo për shkak se është rrezik të mbesin shkollat pa ngrohje, sepse mund t'i marrë mjetet përmbaruesi.

Në mbledhjen e kuvendit kam kërkuar një informatë me shkrim se sa komuna u ka borxh operatorëve ekonomikë. Andaj, po kërkoj përsëri një informatë me shkrim për këtë çështje. Vazhdoni t'i kryeni punët që keni filluar e mos krijoni punë të reja, sepse krijohen shpenzime të reja, e pastaj komuna hyn në obligime.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – sa i përket pyetjeve të çështja e shpenzimeve, tha se bëhet fjalë për obligimet e vitit të kaluar. Prandaj, i tërë ky vit është me obligime të shpenzimeve për vitin e kaluar. Prandaj, ne nuk do të iniciojmë projekte të reja, vetëm ato që janë vazhdimësi, për shkak të obligimeve përmbarimore.

Rritja e shpenzimeve sipas kodeve që u cek, është për shkak të pagesës së obligimeve të vitit të kaluar, sepse nuk do të kishte rritje aq të madhe brenda këtij tremujori.

Kodi 14060 “mirëmbajtja rutinore”, këtu hyjnë rrugët e asfaltuara, mirëmbajtja e tyre, rrugët e rendit të katërt e shumë tjera. Të gjitha ato që e kanë karakterin e shërbimeve kontraktuese hyjnë në “mirëmbajtje rutinore” dhe të “mirëmbajtja e rrugëve lokale”.

Lidhur me kërkesën për informatë se sa komuna u ka borxh operatorëve ekonomikë, ose do ta sjelli në mbledhjen të kuvendit ose me e-mail ta përcjelli.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përmirësohen disa gabime dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private në rr. “Ismail Parduzi në Vushtrri sipas gjendjes faktike.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – theksoi se drejtori është dashur të jetë prezent dhe të na njoftojë saktë për këtë çështje dhe të respektojë ty si kryesuese. Nuk është hera e parë kjo që pas votimit, ministria e kthen ose e shihni ju si qeverisje që është bërë ndonjë gabim. Unë për veti jam kundër, besoj që edhe Ymeri është kundër këtij vendimi, sidomos pa na sqaruar në detaje. Jo vetëm për këtë vendim, por të gjitha vendimet që janë marrë për këmbim të pronës private me atë publike, kemi me i marrë vendimet dhe me i dërguar në gjykatë, sepse nuk po zbatohen. Ne po marrim vendim, po u japim parcela ndërtuesve, ata po e shfrytëzojnë pronën komunale.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se edhe drejtori i kadastrit, por edhe kryetari është dashur të jenë prezent për të dhënë sqarime. Ne do të jemi kundër, por propozoj që të shtyhet për ndonjë seancë të radhës, për shkak se në pikën e tretë të propozim-vendimit thuhet që këto prona u janë nënshtruar vlerësimit të Ministrisë së Financave. Ne këtë vlerësim nuk e kemi në material.

Tek parcela e komunës së Vushtrrisë është 1/1, pra komuna është prona 100%. Kurse, te prona që po kërkon të bëhet këmbimi nga “Ariani Company Shpk”, te njëra pronë është 4/18, kurse te prona tjetër 6/2. Pra, kjo i bie që kjo kompani nuk është pronare 100%, por ka edhe pronarë tjerë.

**Bastri Duraku, udhëheqës i sekretarisë** – sa i përket vlerësimit nga Ministria e Financave, e kemi në sekretari vlerësimin që ka qenë vitin e kaluar kur është. Për kuvend do ta bashkëngjesim këtë vlerësim.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – drejtorët e drejtorive duhet të jenë të pranishëm në KPF e kuvend, kur i kanë pikat e tyre në rend të ditës për të dhënë sqarime.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota “për”, dy (2) “kundër”, një (1) “abstenim” rekomandoi që të plotësohet me vlerësimin nga Minsitria e Financave dhe dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Propozim – vendim për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (hartimin) e rregullores për punën e kuvendit.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

Mbledhja përfundoi në orën **11:30**.

**Bujar Klinaku**



Procesmbajtës



**Melihate Basholli - Latifi**



Kryesuese e KK-së dhe KPF- së